



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 61**

**Datë: 28. 12.2020. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet Nr. 54, 55, 58 dhe 59/2020

**2. Aktivitetet e SKQZ-së**

**3. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

**-Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së vendvotimeve të rinumëruara nga zgjedhjet e vitit 2009-2019,

-Shqyrtimi dhe miratimi i Hulumtimit dhe Analizës së fletëvotimeve të pavlefshme nga zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2019

**-Këshilli për Buxhet dhe Financa**

-Shqyrtimi i raportit për shpenzime të derivateve dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ- së;

-Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të pasurisë së KQZ- së;

**5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021-2023,**

**6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021,**

## 7.Shqyrtimi dhe miratimi i draft Raportit të Auditimit të Përgatitjes së Buxhetit 2021

## 8.Vlerësimi vjetor për Zëdhënësin e KQZ-së.

## 9.Të ndryshme.

---

### **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

*Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet Nr. 54, 55, 58 dhe 59/2020*

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve! Së pari, e përsërisht antaren e re të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga subjekti politik Lista Serbe, e cila, ka dhanë betimin të ejtën. Është kjo, Gordana Llaban. I dëshiroj mirëseardhje , pune të mbarë, gjithashtu i dëshiroj mirëseardhje edhe Qemajlit, il cili është kthi pas një kohe për shkaqe shëndetsore. \

Pra, e hapi mbledhjen e 61-të të Komisionit Qendror të zgjedhjeve me rendin e ditës siq e keni para jush. A ka dikush vërejtje! Po urdhëro Sami!

**Sami Kurteshi:** Faleminderit Zonja kryesuese! Mirë se keni ardh Zonja Allaban në mbledhje. Unë kam një qështje me ngrit për rend të dites në të ndryshme , por si do qoftë edhe ajo ka të bejë me diskutimin, apo trajtimin e qështjes së aplikacionit elektronik për regjistrimin e qytetarëve tanë që jetojnë në botën e jashtme , mërgimtarve si do që e çuani që të mundësohet tash para zgjedhjeve të zgjvillohet ky aplikacion, më gjasë nuk ka qështje ose probleme teknike, shkencore apo ligjore që do ta pamundsonin egzistimin e një aplikacioni të tillë, për ndryshe një aplikacion i tillë, do të minimizonte mundësit e përsëritjes së votuese se do të thotë është apikacion elektronik edhe ato të dhëna do të identifikohen menjëher, edhe mundësia e regjistrimit është shumë më e shpejtë edhe një punë shumë ma e lehtë, për KQZ-në sepse regjistrimi me dorë fizik, kishte me qenë shumë më I vështir. Faleminderit!

**Valdete Daka:** Faleminderit! Në të ndryshme, ne mundemi ta diskutojmë gjithqka po mendoj të gjitha ndërkaq, unë para fillimit të mbledhjes kisha dashtë të adresoj një qështje, e ajo është që duke marr parasysh situatën e krijuar pas aktgjykimit nga gjykata kushtetuese. Ne tashme jemi të vetëdijsëm se zgjedhjet janë të pa shmangshme, natyrisht që na do të presim datën e shpalljes së zgjedhjeve , por gjithsesi unë kisha dashtë me ju vë parasysh të gjitha institucioneve relevante, që të shfrytëzohet afati maksimal, i dhënë kushtetues për datën e shpalljes së zgjedhjeve natyrisht, sepse mos të harrojmë se jemi në ditë para Vitit të Ri, pra i kemi festat shtetore të cilat tashmë i kemi para nesh. Ne, ende nuk e kemi një buxhet të alokuar e as të aprovuar me sa e di unë, kshtu që do të jetë kogja e sfiduar gjithkjo situatë, sidomos për faktin që jemi në prag të festive, kur e dim që asnjë institucion

praktikisht nuk punon dhe ne do të mbetemi i vetmi institucion i cili do të jetë në detyrë në ditët në vijim.

Pra, unë e kisha kërku nga institucionet relevante dhe ato të cilat janë, në dorën e të cilëve është të vendoset, që ti kenë parasysh të gjithë këto fakte e sidomos faktin që KQZ-ja është një institucion i pavarur, i cili do të jetë në detyrë në ditët në vijim, pra unë e kisha kërku nga institucionet relevante dhe ato të cilat janë, në dorën e të cilëve është, të vendoset që ta kenë parasysh të gjitha këto fakte e sidomos faktin që KQZ-ja është një institucion i pavarur i cili deri më tani ka organizu një numër të madh të zgjedhjeve, në mënyrë jashtëzakonisht të suksesshme dhe nuk kisha pas dëshirë që , për shkak të afateve të jashtë zakonishtë të shkurtë të sfidohemi e duke ipas parasysh të gjitha këto që i thash më herët.

Pra' kjo kishte me qenë një qështje nderkaq që natyrishtë na mbesim të gatshëm që ti organizojmë zgjedhjet kurdo që ato të shpallen , por natyrishtë edhe mundësit tona kanë limite , edhe ne kemi edhe limite edhe fizike ndërmjet të tjerave. Nese skemi diçka tjetër. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite tjetër! Nëse jo, kush është për këtë rend dite?

Vazhdojmë me pikën e parë, shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet 54,55,58 dhe 59-të. A ka dikush vërejtje! Po udhero Sami?

**Samir Kurteshi:** Faleminderit Zonja kryesuese. Ne i kemi marr katër procesverbale, që janë me vonesë shumë me vonese, kemi 54, 55 me gjase 56 edhe 57 që mungojnë, ka mundësi që i takojnë mbledhjeve që janë mbajta gjatë ditë së zgjedhjeve, por nuk e di pse mungojnë, edhe kemi 58, 59 do të thotë edhe ashtu jemi gjashtë a shtatë procesverbale pas. Kjo është çështja e parë dhe vërtet, unë për vete sinqerisht po thamë, po harroj qa po themi para 1 muje. E dyta e kemi procesverbalin 54. Në një anë shkruan, thotë personat pjesëmarrës në mbledhje, ndër ta është edhe procesmbajtësi që është shumë në rregull. K'nej në fund të procesverbalit e ndërpret procesverbalin, e thote se ka përfundu stenogrami, por në qofse ai është pjesë e mbledhjes, nuk mundet mu mvar në stenogram. Kjo që është është përsëri teknike por është pak paradoks. Nëse është këtu nuk lidhet me stenogramin.

Çështja tjetër është se, unë edhe një herë po kërkoj përfundimisht. Që në mbledhjen pasuese të miratohet procesverbalin I mbledhjes së kaluar, kur ne i kemi gjërat e freskëta të cilat i kemi diskutuar edhe të mos mirremi tash. I kemi 1 , 2 mungojn 4 ,5 , 6 , 7 procesverbale me vone. Unë krejt sinqerisht po ju pyes? A e dini cka ka n'gja në procesverbalin 55, nuk e di nuk është në rregull kjo!

**Valdete Daka:** Mirë atëherë, nëse nuk kemi diçka tjetër vërejtje lidhur me procesverbalet. Nëse jo! Kush është për miratimet e tyre tashme e kemi këtë situatë, nuk është hera e parë që diskutojmë. Mirë kush është për aprovimin e këtyre procesverbaleve. Faleminderit! Kush është kundër? Kush apstenon? Me dy vota

apstenim, aprovohen procesverbalet. Vazhdojmë me aktivitetet e SKQZ-së. Urdhëro Burim?

### **1. Aktivitetet e SKQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryetare! Të nderuar anëtare të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Raportin me aktivitete të sekretariatit e keni pas në e-mail kështu që, janë tri aktivitete kryesore që, është duke punuar sekretariati. Është në kuadër të planit të punës 2020 ku, do ti nënshtrohet vlerësimit nga sekretariati për zbatimin e planit të punës 2020. Po ashtu sekretariati është duke punuar edhe në draftimin, në planin e punës 2021 por, t'i listuar të gjitha ato aktivitete të cilat do të jenë në draft, si dhe përgatitjet e draft buxhetit dhe draft planit operacional në bazë të vendimit të gjykatës kushtetuese.

Pra, këto janë ato aktivitete kryesore në të cilat sekretariati I ka punuar gjatë këtyre ditëve, dhe ne e-mail e keni pasur edhe raportin me shkrim kështu, që për çdo informacion këtu do të jemi dhe do të japim përgjigje. Faleminderit!

**Valdete Daka:** Faleminderit! A kemi pyetje...?

**Alim Rama:** Unë, nuk e di sa herë po e përsërisë të njëjtën pyetje? Unë nuk e di në çfarë cilësie, Burimi e prezantojë në emër të sekretariatit, ku tashme e kemi një vendim të gjykatës komunale, kemi një vendim të KPMSHPC-se i cili ka konstatuar që procesi i zgjedhjes së krye shefit ka qenë i korruptuar dhe jo i rregullt. Ndërkohë, ai vendim e ka udhëzuar KQZ-në dhe e pash që ju keni reaguar menjëherë, që procesi të kthehet në zero. E ka shkel para se gjithash sigurinë juridike, ndërsa ka ardhur një vendim shpejt e shpejt deri se, edhe në vendimin e KQZ-së nuk ceket që krye shefi i zgjedhur në atë proces, është dashtë me ushtrua detyrën. Aty, ceket që krye shefi të merr detyrën, në bazë mbasi që të respektohen procedurat.

Tash, na kemi një vendim për zbatimin e vendimit i cili i referohet vendimit të parë por, unë ende nuk po shoh në çfarë cilësie Burimi e përfaqëson sekretariatit këtu. Edhe desha me përfunduar, me sa e di unë ende nuk ja keni nënshkru emërimin?

**Valdete Daka:** Jo, tashmë na e kemi një vendim të gjykatës themelore në Prishtinë, e cila gjykatë e ka pezulluar zbatimin e vendimit të KPMSHC-së dhe na deri sa të bëhet ai vendim i plotë fuqishëm, kemi obligim që ta zbatojmë. Në momentin që vjen diçka tjetër na do ta zbatojmë patjetër. Vazhdojmë me pikat që i kemi, aktivitetet e ZRPPC-së. Urdhëro Yll.

Rreth kësaj çështjeje, diskutuan: Alim Rama, Eshref Vishi, Valdete Daka e cila, kërkoi të vazhdohet me pikat e rendit të ditës...

## **2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Yll Buleshkaj:** Faleminderit shumë. Kryetare e nderuar, të nderur anëtarë, të nderuara media. Tash jemi si zyre në periudhë mjaftë interesante, jemi në pritje të raportit financiar për fushatë, për zgjedhjet për kryetarë të komunës së Podujevës dhe në Mitrovicën e Veriut. Deri më tani ashtu siç e dini, kemi pranuar një raport edhe për atë raport është përgatitur edhe dosja për informim publik, e cila për mbanë raportin financiar, deklarinimin financiar të kandidatëve dhe listën e donatorëve. Të gjitha këto, po sa ti pranojmë të gjitha raportet e partive tjera politike, do ti publikojmë ashtu siç është vendosur KQZ-ja pas datën 12 janar ku është edhe afati i fundit për dorëzim të raporteve.

Nga ana tjetër, jemi shumë të zënë këto ditë, duke këshilluar partitë politike, po ashtu edhe iniciativat për themelim të partive politike apo iniciativa qytetare, duke që vendimi i gjykatës kushtetuese ka ngjall një interes të veçantë, për iniciativa të reja. Janë të interesum edhe për kushtet të cilat duhet ti plotësojmë për tu certifikuar. Ka shumë edhe nga komunitetet, çka është shumë e rëndësishme që më parë nuk ka pas, kemi pas kontakte, nga mund të them 10 iniciativa tash a materializohen a jo në të ardhmen nuk e dimë, por janë dikun 10 që këto kanë rezultuar edhe dikun 10 takime që i kemi pas me këto iniciativa edhe i kemi këshillua në përgjithësi sepse afatet, edhe formularët bëhen publik atëherë kur shpallen zgjedhjet. Por në si detyrë e kemi ti këshillojmë me gjërat kryesore, që janë si kushte për tu certifikuar.

Po ashtu, kemi, jap kontribut në zyrë të planifikimet që është duke i bërë sekretariati për zgjedhjet e mundshme për kuvendin e Kosovës. Po ashtu edhe te ana buxhetore po ashtu edhe nga plani operacional. Për veç kësaj kemi edhe një numër të aktiviteteve të cilat jemi në përfundim këtë vit, po ashtu një nga këto është edhe monitorimi i kuvendeve të partive politike, të kuvendeve zgjedhore edhe kjo është një punë shtesë sepse shumë parti po kanë problem në organizimin e zgjedhjeve edhe na kanë kontaktuar për procedurën.

Ne, i kemi njoftuar, ashtu siç i kemi pas edhe në të kaluarën, si praktik që në qoftë se nuk mund të realizohen për shkak të rrethanave objektivat, ata duhet të dorëzojnë kërkesë në zyre e ne pastaj do ti rekomandojmë tek KQZ-ja për vendim marrje në qoftë se është e nevojshme shtyrja e atyre afateve për mbajtjen e zgjedhjeve të brendshme.

**Valdete Daka:** Faleminderit Yll. Nëse s'kemi keni pyetje vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së. Këshilli për operacione zgjedhore.

## **3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

## **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

### Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës së vendvotimeve të rinumëruara nga zgjedhjet e vitit 2009-2019:

**Alim Rama:** Faleminderit kryesuese. Këshilli për operacione zgjedhore e ka aprovua dhe iu rekomandon KQZ-së për aprovim, analizimin e vendvotimeve të rinumëruara në QNR. Kjo analizë i përmban të gjitha vendvotimet që janë rinumëruar për tre lloje shkaqe të ndryshme zakonisht, që i kanë nda në tri grupe, në bazë të vendimeve të PZAP-S, në bazë të votave nga karantina dhe në bazë të vendvotimeve nga auditimi i brendshëm i QNR-së. Raporti është i punuar mirë i jep të dhënat specifike për secilin lloj të rinumërimeve që kanë ndodhur. Fatkeqësisht KQZ-ja numri i rinumërimeve pas 2014-tës njëherë kemi pasur numrin e madh të rinumërimeve në procesin e 2010-tës që veç njihet si vjedhje industriale. Tash fatkeqësisht edhe raportet e dy viteve të fundit tregon që ka një rritje të votave për rinumërimin.

Është një varg i rekomandimeve që këto të mos ndodhin në të ardhmen posaçërisht që kufizohet në plotësimin e saktë të formularëve po ashtu në rritjen e kapaciteteve të trajnimeve të trupave zgjedhore. Zakonisht arsyet e rinumërimit kanë qenë për shkak të diskrepancës midis numrave, midis subjekteve dhe kandidateve. Ndërsa ka pasur rast kur subjektet nuk kanë votën ndërsa kandidatet kanë pasur votën në atë vendvotim. Një prej rekomandimeve shtesë që e ka rekomanduar QNR-ja është që të analizohet. Natyra e PZAP-s të krijohet që të ketë një bashkëpunim në të ardhmen të ketë një koordinim midis KQZ-s dhe PZAP-s që mos të ketë paqartësi se në zgjedhjet e 2019-tës kemi diku 1490 vendvotime, gati 50% kanë qenë me iniciativë të PZAP-s janë bërë rinumërimi.

Ne, në një analizë tjetër këshilli për operacione zgjedhore e kemi parë që ekziston paqartësi kush është përgjegjës për trajnim, por atë e trajtojmë në një mbledhje tjetër të KQZ-s por ajo na konfirmon këtë që pjesa e fajit i takon KQZ-s për shkak të mos strukturimit të duhur të trajnimeve sepse këtu trajnimet janë cekur si një prej rritja e trajnimeve në këtë analizë ceket si një prej të gjeturave kryesore, faleminderit.

**Valdete Daka:** Faleminderit Halim. A ka dikush pyetje? Është një studim për një analizë e cila me siguri që do të na shërbej në punën ton edhe e cila me siguri do të na jep në bazë të rekomandimeve mundësin që ta përmirësojmë dhe ti bijmë numrin e kutive të rinumëruar në minimum. Shpresoj që në zgjedhjet të cilat janë duke na prituri ti aplikojmë edhe këto rekomandime. Kush është për aprovimin e kësaj analize?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë analizë.

### Shqyrtimi dhe miratimi i hulumtimit dhe analizës së fletëvotimeve të pavlefshme nga zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2019:

**Alim Rama:** Faleminderit kryetare. Është në këshillin për operacione zgjedhore kemi trajtuar edhe një analizë e cila bënë për analizimin e fletëvotimeve të pa vlefshme për Zgjedhjet e Kuvendit 2019. Kjo analizë na tregon në mënyrë numerike natyrën e fletëvotime të pa vlefshme edhe % e tyre për vetëm zgjedhjeve të 2019 por edhe na jep edhe të dhënat prej zgjedhjeve 2001 deri në 2019. Ku përqindja e votave të pavlefshme në zgjedhjet e fundit 2019 është 3.81% që është një ulje prej vitit 2017 ku ka qenë 6.3%, ku paraprakisht kemi pasur 2.6% në 2014, 2010 kanë qenë 4.6%, në 2007 9.05% e kështu me radhë. Por këtu vlen të ceket që në të njëjtin proces zgjedhor është një e veçantë, në të njëjtin proces zgjedhor ku kemi pasur për kuvende komunale numri i votave të pa vlefshme për asamble komunale ka qenë shumë më i madh se sa për kryetar të komunave që na jep edhe në rekomandim një prej mundësive është diçka me fletëvotime.

Kështu, rekomandimet në bazë të kësaj analizës që këto të minimizohen se ne jemi të gjithë të vetëdijshëm se nuk mundemi ti bëjmë ato zero, por numri i tyre të zvogëlohet ka qenë që të rritet kualiteti i informimit të votuesve, të rritet niveli profesional i anëtarëve të KVV-ve. Po ashtu ka qenë një prej rekomandimeve që u trajtua në një analizë të ngjashme ka qenë studimi i dizajnit që mundet të jetë një prej pasojave të fletëvotimeve të pavlefshme. Zakonisht votimi i fletëvotimeve të pavlefshme në 50% të tyre ka qenë që vlen të ceket janë zgjedhur kandidatët por jo edhe subjekti politik. Kështu që kjo është një natyrë që duhet të ceket se vota për kandidat nuk vlen qoftes nuk zgjidhet paraprakisht subjekti politik. Kështu që në mënyrë unanime ju rekomandohet për aprovim.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Është mirë që në bazë të kësaj analize kemi uljen e fletëvotimeve të pa vlefshme në zgjedhjet e fundit kemi vetëm 3.8% nga numri total e fletëvotimeve besoj që ndoshta do të ulet edhe më shumë marrë parasysh që tash edhe kemi zgjedhje pothuajse çdo vit. Atëherë me siguri se qytetarët e dinë si votohet. Atëherë kush është për aprovimin e këtij hulumtimi, analize?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë analizë.

#### **4.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

Shqyrtimi i raportit për shpenzime të derivateve dhe kilometrat e kaluara për veturat e KQZ- së:

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Ne në këshillin për buxhet e kemi shqyrtuar raportin për shpenzime të derivateve dhe kilometrat e kaluara për vetura të KQZ-s në periudhën janar-shtator, periudhë të cilën e kemi trajtuar edhe më herët e kemi rikthyer me një krahasim të 2019. Është një konstatim se nga periudha e njëjtë e vitit 2019-2020 shpenzimet janë për 30% më t'u ulëta në kuptimin edhe të kilometrave edhe të shpenzimeve të derivateve, shpenzimi për vetuar është përafërsisht i njësoj siç ka qenë, do me thënë që raporti i plotëson kriteret të kërkuara sipas rregullës.

Një rekomandim që vjen nga këshilli për buxhet dhe financa po është edhe ai i cili bien nga rekomandimi nga auditorit të brendshëm dhe nga zyra kombëtare e auditimit që nuk është përfillur udhëzimi i administrativ në shfrytëzimin e veturave dhe duhet të rishikohet çështja e udhëzimit administrativ rregullës, prandaj me këtë sugjerime që KQZ-ja dhe sekretariati që të punojnë dhe të bien një udhëzim sa më shpejt që është e mundur në kuptimin që të plotësohen rekomandimet që kanë ardhur nga zyra e auditorit të përgjithshëm po ashtu edhe nga auditori i brendshëm. Për ndryshe raporti si raport i shpenzimeve dhe pjesa tjetër, është konform rregullave që i ka aprovuar KQZ-ja.

**Valdete Daka:** Faleminderit. A kemi diçka tjetër?

**Alim Rama:** Pasi që herën e parë e kam ngritur si çështje, në mungesë të informatave. Këto informata e plotësuara veç e konfirmuan atë se si e tha edhe kolegu që veturat nuk po përdoren në bazë të udhëzimit administrativ, ato janë në shpërputhje njëra me tjetrën, por deri sa vjen deri tek udhëzimi, ose korrigjimi i udhëzimeve ose raportet të kenë përputhje gati për secilën veturë që nuk ceket qëllimi i përdorimit të automjeteve.

Është shumë më rëndësi që mjetet e KQZ-ës janë mjete publike, naftë të shpenzuar janë nga mjetet publike, që ceket që edhe veturat të përdoren vetëm për qëllime që lidhen me punët e KQZ-ës. Se nëse ne si anëtar të KQZ-ës nuk i respektojmë rregullat mendoj që sekretariati s'ka nevojë hiq të i respektojë. Sepse, ne po i shikojmë që për secilin automjet nuk e tregon se për çfarë është përdorur ato automjete, rregullat në udhëzime administrativ janë shumë të qarta, automjete duhet të shfrytëzohen në lidhje me punën e KQZ-ës dhe jo për diçka tjetër dhe për vajtje dhe ardhje të anëtareve KQZ-ës dhe Krye shefin.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Tashmë, e kemi këtë vërejtje po thuajse se çdo vit nga auditori gjeneral dhe kemi pasur vërejtje që ta bëjmë harmonizimin e këti udhëzimit më kërkesat sipas vërejtjeve e kemi tash edhe rekomandimin që ka dalur nga këshilli, kështu që me siguri që gjatë ditëve ne vijim duhet ta bëjmë harmonizimin e këtij udhëzimit dhe ta shqyrtojmë edhe një herë mënyrën se si behet përdorimi i këtyre veturave. Nëse, nuk kemi diçka tjetër...

**Burim Ahmetaj:** Faleminderit kryetare. Sekretariati sigurisht që administron edhe qëllimin e shfrytëzimit të veturave dhe sigurisht që këtu i kemi të gjithë formularët, te cilat identifikojnë detaje edhe qëllimin e shfrytëzimit të veturave, dhe ju siguroj që të gjitha veturat janë shfrytëzuar për qëllime të punës dhe këto i kemi në raportet e detajshme, te cilat nuk janë këtu por këto janë të reflektuara nga raportet dhe nga dokumentet për shfrytëzimin e veturave. Pra dihet qëllimi dhe dihet destinacioni për çdo shfrytëzim të veturave. Kështu që ato detaje nuk janë të pasqyruara, mirëpo janë të pasqyruara vetëm shfrytëzimi. Të gjitha veturat janë shfrytëzuar për çështje të punës. Faleminderit.



**Valdete Daka:** A ka dikush pyetje?

**Alim Rama:** Nuk është plotësuar formulari për disa vetura, ceket që për disa vetura formulari nuk është plotësuar, edhe për anëtarët e KQZ-ës dhe për kryeshefin duhet që të tregohet që për çfarë arsye shfrytëzohet ai automjet.

**Valdete Daka:** Kush është për aprovimin e këtij raportit?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë raport.

### **5.Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të pasurisë së KQZ- së:**

**Sami Hamiti:** S'i pikën tjetër të cilën e kemi shqyrtuar, është shqyrtimi i raportit të vlerësimit të pasurisë së KQZ-ës, këtë e kemi shqyrtuar në mbledhjen e me hershme të këshillit për buxhet, me një sugjerime dhe kërkesë që të na behet një listë plotësuese, që nuk e kemi trajtuar 2 herë për këshillin për buxhet, e kemi vendosur që të trajtohet drejt për drejt çështja e pasurisë se çfarë duhet të asgjësohet dhe çfarë të shitet dhe çka mundet të jepet si donacion në pjesën tjetër që ka tejkaluar, konstatim në këshillin për buxhet ka qenë që është një raport i vlerësimit që faktikisht kërkesat e vazhdueshme që kanë qenë 2-3 vitet e fundit, po flas edhe për këtë rast, për rastin e parë për udhëzimin administrativ dhe këtu ka qenë një kërkesë edhe nga auditori, zyra e auditorit gjeneral edhe nga auditori i brendshëm që nuk ka evidencë të plot të pasurisë në KQZ-ë.

Një komision i cili është formuar dhe, them që e ka kryer një punë shumë të madhe, nuk e ka pasur lehtë sepse është dashur për herë të parë të identifikon të bëjë një regjistrim me të plot sepse nuk ka pasur evidencë, sepse raporte krahasuese nuk kanë pasur, por është bërë një punë shumë e madhe dhe që na shtojnë që të besojmë që në vitin 2021 do të kenë edhe evidenca edhe relacion krahasues për regjistrimin e kësaj pasurie.

Tani, po them edhe duke lexuar planin vjetor të auditorit dhe po shoh që për vitin e ardhëm 2 auditime që ndërlidhen edhe më evidencën, regjistrimin po ashtu dhe me pjesën tjetër të menaxhimit të këtyre, si raport fillestar një konstatim nga këshilli për buxhet që është një nisem shumë e mirë, për herë të parë më e plot dhe nga këshilli për buxhet me kërkesën që të behet një evidencë e tillë për të cilën mundet që dikush të ketë vërejtje që ka njohuri me të thella në kuptimin e atyre elementeve nga teknologjia informative ose pjesës tjetër në parim e kemi përkrahur edhe kemi marrur një vendim që ti propozohet KQZ-ës të votohet.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Bashkangjitur këtij raportit, ne e kemi edhe një rekomandim për pasuritë jo financiare dhe jashtë përdorimit, e kemi parasysh dhe nga ne kërkohet që të lejohet asgjësimi i disa pasurive jo financiare. Kemi të bëjmë me uv-sprehat të cilave ju ka skaduar afati, kemi pastaj dhe rekomandimin e 2 që të

shiten përmes ankandit pasurit të cilat pastaj ceken. Por, unë një çështje nuk e kam te qartë UVE-llampat nuk janë të përdorshme, janë të prishura apo çfarë...?

**Burim Ahmetaj:** Është një sasi enorme, janë të grumbulluara ndër vite...!

**Valdete Daka:** Kabinat e votimit ? Edhe ato janë të dëmtuara, edhe kutitë votimi, 722 kuti votimi janë të dëmtuara...?

**Burim Ahmetaj:** Të dëmtuara, po...

**Alim Rama:** Në pikën 1 të rekomandimit të asgjësohen 22... UVE-sprehat, t'i shtohet edhe me përputhje me ambientin sepse këto janë me përbërje kimike dhe standarde për ruajtjen e ambientit.

**Valdete Daka:** Ne gjithmonë i kemi asgjësuar në bashkëpunim me ministrin e ambientit. Por vetëm desha që të ja sugjeroj sekretariatit që kur benë kërkesa për UVE-spreha dhe llampa ta ketë parasysh faktin që ato mbesin shumica prej tyre dhe kur të porositen që të mos kërkohet që të jetë afati 1 vjet që të ju kalon afati pas një viti por, të kenë afat me të gjatë të përdorimit sepse, po na bije që ti blejmë dhe ti gjuajmë! Sepse, disa prej tyre nuk përdoren dhe te kemi parasysh se sa janë përdorur në zgjedhjet e kaluara dhe sa është e arsyeshme të blihen sepse, nga ky raport po shifet që panevojshëm janë blerë një numër i madh i tyre...

**Burim Ahmetaj:** Pra para jush i keni 4 rekomandime, i pari që lidhet me asgjësimin e spreheve që ne tansi janë 22... të cilat do të shohim edhe me ministrin e ambientit mënyrën e asgjësimit të tyre. Rekomandimi i 2 ka të bëjë me artikujt të cilat do të shiten përmes ankandit dhe ju informoj se i keni në dokumente të cilat i ka të gjitha këto artikujt që janë në mënyrë përmbledhëse të paraqitura këtu mirëpo në dokumentin i keni sipas kategorive të selektuara të gjithë artikujt rekomandimet të cilat ju të gjithë i keni para vetes.

Rekomandimi i 3, është për artikujt të cilët do të jepen si donacion dhe rekomandimi i 4 është që një pjesë e pajisjeve që kanë qenë gjatë regjistrimit të materialit të ndjeshëm të kthehen në përdorim edhe pse ju ka jep statusi i tyre jashtë përdorimit, pra janë këto 4 kategori të cilat rekomandohet nga KQZ-ja dhe mënyra përmbledhëse e këtyre e sidomos të kategorisë 2 dhe kategorisë 4 janë në dokumentet të sqaruara të gjitha. Pra, janë të gjitha këta artikujt të cilët e sidomos të rekomandimi 2 të cilat do të shiten përmes ankandit dhe janë me të vjetra me shumë se 10 vite edhe po thuajse vlera e tyre është 0, dhe janë jashtë përdorimit. Sa i përket llampave, ato blihen për përdorimin e tyre mirëpo, ato sigurisht që do të përdoren gjatë procesit të zgjedhjeve dhe, deri në kthimin në KQZ, edhe një numër i tyre mund të dalë jashtë përdorimit...Janë, materiale të dalura jashtë përdorimit, të dala ndër vite...

**Alim Rama:** Në plan të punës nga këshilli i operacioneve zgjedhore ka qenë edhe studimi i mënyrës së ndryshme për hudhje të spreheve dhe forma tjera por fatkeqësisht ky aktivitet nuk i është përmblyllur, kështu që për shkak të afateve, para

se këto te asgjësohen. Unë, kisha rekomanduar që sekretariati të i provon këto, posaçërisht sprejet në qoftë që kanë ende vlefshmërinë që te jenë shumë të kujdesshëm se si përdoren edhe sa është jetë gjatësia e tyre është shumë me rëndësi.

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë. E para jemi duke folur për një proces të rëndësishëm zgjedhor që po na pret dhe nuk kemi kohë për eksperimente. Si Komision Qendror i Zgjedhjeve andaj duhet të jemi të përkushtuar, eksperiment i afatit kohor të vlefshmërive të sprejeve, ne nuk jemi ekspert të saj.

E para, desha të e përgëzoj sekretariatit e KQZ-ës për një punë të palodhshme që e kanë bërë lidhur me këtë raport të vlerësimit, është edhe një çështje e cila është ngritur edhe në raportin e auditimit të vitit të kaluar si gjetje, për shkak që nuk kemi pasur një evidencë të qartë të pasurisë të KQZ-ës të blerë ndër vite edhe të poseduar ndër vite, andaj është ky një sukses për një evidencë të qartë një pasqyrim të qartë të gjerave që realisht i kemi në posedim dhe të atyre që duhet të asgjësohen për shkaqe që janë jashtë përdorimit apo te atyre që duhet te ju ndërrohen. Faleminderit kryetare.

**Valdete Daka:** Faleminderit atëherë të gjithëve. A ka dikush vërejtje diçka? Nëse jo. Kush është për aprovimin e këtij raportit 'raporti për vlerësimin e pasurisë jo financiare të KQZ-ës së bashku me rekomandim? Edhe mos të harrojmë që një nga rekomandimet është që edhe një sasi e tabletave tashmë të vjetër të i dhurohen ndonjë institucionit apo OJQ-ve. Kush është për ? Faleminderit.

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan këtë raport, bashkë me rekomandime.

## **6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021-2023,**

**Eshref Vishi:** Faleminderit kryetare. Plani strategjik i auditorit të brendshëm të KQZ-ës për vitin 2021-23, paraqet objektivat kryesor, fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm të KQZ-ës. Objektivat e auditimit janë në pajtueshmëri me qëllimet dhe autorizimet kushtetuese dhe ligjore që ka KQZ-ja. Ky plan është ndërtuar edhe mbi bazën e standardeve të auditimit, kërkesave ligjore, vlerësimit të rreziqeve, statusin e njësisë së auditimit dhe metodologjinë për auditimin e brendshëm në sektorin publikë.

Strategjia, tha mw tej z. Vishi, do i shërbej si bazë për zhvillimin e planit vjetor të aktiviteteve të auditimit brendshëm, kur njësia e auditorit të brendshëm është përgjegjës për kryerjen e auditimeve të brendshme të të gjithave njësive strukturale, programeve, aktiviteteve, sistemeve dhe proceseve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Ky plan strategjik, do të rishikohet edhe azhurnohet në bazë të vlerësimit të rrezikut. Objektivat, fushëveprimi strategjik dhe faktorët e rrezikut janë të

evidentuara dhe përpunuar në mënyrë profesionale dhe se planet vjetore të punës do të reflektojnë përmbushjen e objektivave të vendosura në planin strategjik. Hartusi i strategjisë me të drejtë e vlerëson i vlerëson edhe sfidat, e mos përmbushjes eventuale të planit strategjikë dhe me këtë edhe të planeve të punës për shkak. Prandaj, ne miratojmë për rekomandim....

**Valdete Daka:** Nëse nuk kemi diçka tjetër. Atëherë, kush është për aprovimin planit?

Anëtarët e KQZ-së, në mënyrë unanime miratimi i Planit Strategjik të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021-2023,

## **6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vjetor të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021:**

**Eshref Vishi:** Ky plan, është përpiluar në bazë të planit strategjik që e miratuar tani të aktiviteteve të auditorit të brendshëm për vitin 2021-2023, dhe përkufizon fushëveprimin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e detyrës së aludimit. Bazuar në përgjegjësitë ligjore, njësia e aludimit do të bëjë auditimin e brendshëm sipas planit dhe dinamikës së paraparë. S'i i tillë, plani duhet të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojave që i ka KQZ.

Në plan, janë përfshirë edhe aktivitetet e njësisë së aludimit për arritjen e objektivave strategjike, elementet kyçe të kontrollit të brendshëm në mënyrë që menaxhmentit t'u jepet një siguri në mënyrë që të planifikojnë, zbatojnë dhe kontrollojnë punën që e bëjnë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Z. Vishi, më tej pasqyroi detyrat dhe përgjegjësitë që dalin në këtë drejtim. Dhe në fund, ai, propozoi që ky plan të aprovohet.

**Sami Hamiti:** Unë, e kam pa planin vjetor dhe me ka pëlqyer shumë, intuïta dhe planit që e ka ber zyrtari apo auditori brendshëm pikërisht problemet që i kemi rreth inventarizimit dhe pasurisë, po ashtu, edhe menaxhimin e pasurisë jo financiare, të cilat i lame si pjesë që do te vazhdohet për vitin 2021. Prandaj, e përgëzoj auditorin...

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan planin vjetor të auditorit të brendshëm për vitin 2021.

## **7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Raportit të Auditimit të Përgatitjes së Buxhetit 2021:**

**Eshrf Vishi:** Atëherë, dy fjalë për këtë raport. Raporti në fjalë, përmbledh çështjet që dalin nga auditimi dhe aktivitetet e përgatitjes së buxhetit të vitit 2021 dhe rishikimi i buxhetit të vitit 2020. Raporti është i përgatitur me standarde dhe me përputhje me kërkesa ligjore, qëllimi është i qartë po ashtu edhe objektivat janë sqaruar dhe të evidentuara në raport të cilat janë hartuar mbi bazën e vlerësimit të rrezikut dhe janë të mbështetura në planin e auditimit. Është audituar rregullsia dhe sistemi aplikativ, pra është audituar dhe vlerësuar përputhshmëria e procedurave të zhvilluara për përgatitjen e buxhetit 2021, me dokumentet bazike të lëshuara nga ministria e financave përfshirë karshi dhe qarkoret buxhetore.

Po ashtu, dhe rregullsia në krijimin në kuptim të ndarjeve të përgjithësive të nivelit për përgatitjen e buxhetit sipas kërkesave të ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike. Karakteristik e këtij auditimit është së nga aktivitetet e audituara vetëm në një procedurë ka të gjetura dhe rekomandimi rezulton vetëm mbi këtë proces apo procedurë. Procesi i buxhetimit dhe ndarja e detyrave dhe përgjithësive, bazuar në sistemin apo sistemin e organizimit të KQZ-ës edhe obligimet ligjore nga ligji në fuqi, KQZ-ja ka të organizuar ndarjen e detyrave dhe përgjithësive në harmoni të plot me to, të cilat sigurojnë zbatim të plot të obligimeve ligjore, të gjetura nuk ka.

Pika 2 tek zbatimi i procedurës për përgatitjen dhe aprovimin e buxhetit të KQZ-ës gjetje nuk ka, pra gjithë procesi i përgatitjes së buxhetit deri në aprovimin e të bazohet në 2 dokumente bazike të lëshuara nga ministria e financave e këto dokumente përfshijn kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe qarkoret buxhetore. Pika 3, detajizimi dhe përgatitja e buxhetit sipas kodeve ekonomike dhe njësive kërkuese po ashtu edhe këtu nuk ka të gjetura, sekretariati zbaton në mënyrë të detajuar përgatitjen e buxhetit, aplikon kategorinë e buxhetit sipas kodeve ekonomike dhe po ashtu buxheti është i përgatitur dhe i detajizuar sipas njësive. Mirëpo tek pritshmëria e buxhetit të miratuar më qëllime dhe objektiva të KQZ-ës, apo struktura buxhetore kemi të gjetura, të gjeturat rezultojnë tek struktura aktuale e buxhetit nuk siguron arritje të buxhetit të KQZ-ës të përcaktuara me dokumente strategjike, buxheti për shpenzime të operimit dhe suversionet përben mesatarisht 90% të buxhetit për secilin vit buxhetor, pjesa e buxhetit që siguron arritjen e objektivave afate gjatë ku përfshihet për arsimim, trajnim të stafit dhe projektet kapitale përben 10% të buxhetit.

Qëllimet e planifikimit të buxhetit për arsimim dhe trajnim, tha më tej z. Vishi, nuk kanë përputhshmëri permbajtore në implementimin e buxhetit, këto janë gjetjet në këtë çështje dhe se shpenzimet janë teje të vogla sa i përket trajnimit dhe arsimit të stafit. Rreziku është që vazhdimi me tutje në këtë struktur buxhetore specifikisht në kategoritë që sigurojnë rritjen e objektivave afatgjate paraqet rrezik që ato dhe objektivat asnjëherë të mos arrihen, po ashtu dhe shkalla e ulet e shpenzimeve të buxhetit për këto kategori paraqet një dobësi menaxheriale në fokusimin e ti për implementimin e buxhetit në kategori specifike, pra të gjeturat kanë të bëjnë më shpenzimet dhe planifikimet por jo dhe më procedurat e përgatitjes që janë të audituara.

Në përfundim, rekomandimet e dalura nga raporti i auditimit konsideroj se duhet të zbatohen nga sekretariati dhe së menaxhmenti është përgjegjës që të raportoj për zbatimet e tyre, njëkohesisht edhe të i adresoj dhe trajtoj lëshimet e tilla në kompetencë. Në fund e përgëzoj drejtoreshën Miradie dhe stafin e saj për përkushtim dhe për profesionalizëm në ushtrimin e përgjithësive dhe përmbushjen e detyrave që i kanë...

**Valdete Daka:** Faleminderit. A ka dikush tjetër...?

**Sami Hamiti:** Faleminderit, po ashtu e kam analizuar raportin për kryerjen e auditimit procesit të përgatitjes së buxhetit dhe rishikimit të buxhetit. Auditori në këtë rast i ka ndarë shumë saktë 2 proceset, procesin e hartimit të buxhetit të cilit nuk ka asnjë të gjetur sepse KQZ-ja i ka saktë të përcaktuara detyrat, në këtë kategori nuk ka pas asnjë shkarje, do të thotë që nga përgatitja, konkluzion i plot është që të gjitha dikasteret kanë bashkëpunuar dhe kanë ardhur të një hartim i buxhetit i cili në aspektin teknik funksionon si ora.

Problemin që e ka vërejtur saktë, është problemi të struktura e këtij buxhetit në kuptimin e ngritjes së kapaciteteve dhe profesionale brenda dhe investimeve kapitale, të cilat dhe me herët në i diskutuam pak a shumë, drejtoresha e buxhetit na sqaroi gjendjen financiare dhe të buxhetit për këtë vit, treguam që niveli i shpenzimit buxhetor e kalon 90%, sepse janë subvencionet për parti politike 4.000.000. Pjesa që ju bien saktë sekretariatit për ti treguar saktë si i kanë shpenzuar dhe a i kanë shpenzuar drejtë dhe a i kanë kryer projektet është pikërisht ai 10%, prandaj auditori saktë e ka pa dhe duhet që herën tjetër në planifikimin e buxhetit të ketë kujdes në strukturën e buxhetit në kuptimin ndaljes po ashtu edhe të ngritjes profesional, trajnimit të atyre specajalistave të zgjedhjeve që në aspektin e auditorit e ka sqaruar shumë mirë dhe pjesën tjetër e cila e lidh më investime kapitale, këto janë investime sipas planit strategjik. Prandaj, konsideroj që është një raport shumë i mirë.

**Valdete Daka:** Po urdhëroni...!

**Sylejman Gashi, auditor i brendshëm:** Në aspektin e rregullsisë procesi buxhetor tek ne funksionon mirë, në të gjitha fazat dhe përgjithësi që duhet të jen, nga propozimi i buxhetit e deri në vendimmarrje që është në KQZ. Është një proces që nuk është i përkryer por është në formën më të mirë dhe qëllimisht Samiu e sqaroi mirë për rekomandimet të gjetura, rekomandimet kanë të bëjnë më shumë menaxherial se sa që ka të bëjë më çështjen teknike dhe ato praktike. Unë kam biseduar edhe me meaxhemtin për pjesët kryesore të te gjeturave dhe rekomandimeve, pra buxhetin e kemi këta që e kemi, në nuk kemi mundësin më pas një buxhet më ndryshe sepse kjo varet edhe nga treguesve makroekonomik pasi qeveria e përcakton këtë vet.

Mirëpo, unë jam i fokusuar në aspektin e kontributit të menaxhmentit me atë strukturë që kemi të buxhetit, nëse mundemi më e ndryshuar aty ku janë mundësit për tu ndryshuar dhe një farë forme, format se si këto 2 kategori për arritjen e objektivave të institucionit ton për tu rritur duke e bër një rishikim të atyre pozicioneve të cilat janë të funksionimit dhe të shpenzimit operacionale. Kështu që unë thash që me shumë ka të bëjë më rekomandim menaxherial që ka të bëjë me politikat menaxheriale se sa më çështje konkrete dhe ato praktike.

Unë, tha z. Gashi, po e lexoj se si është pjesëmarrja në strukturën e përgjithshme të buxhetit: menaxhmentit i sekretariatit të KQZ-ës, duhet të përgatis një plan të arsimit dhe trajnimit të stafit të përhershëm më prioritet të stafit e cilësuar si specialist zgjedhor dhe fushëveprimi i trajnimit të tyre të jetë po ashtu nga fusha e zgjedhjeve. Planet e përgatitura, por këtu është çështja sepse ne nuk kemi plane të përgatitura për arsimimin dhe trajnimin e stafit zgjedhor, nuk e kemi atë plan.

Ndërkohë, kemi planifikime buxhetore, që i kemi gati 30.000 euro çdo vit dhe ai buxhet është i pabazuar në një planë të arsimimit dhe trajnimit, dhe kur merret parasysh që ky buxhet nuk shpenzohet, do të thotë që ne nuk kemi nevojë të planifikojmë, edhe e kemi buxhetin por nuk i shpenzojmë. Kjo punë duhet të zgjedhet me përgatitje të planit që kush janë ata zyrtar që duhet të arsimohen apo të trajnohen, pra duhet të bëhet një planë dhe në bazë të planit të parët i kemi. Pika 2 është për projekte kapitale që ne kemi pak buxhet për këtë qëndrim, edhe atë pak buxhet vazhdimisht kemi treguar që nuk i kemi shpenzuar parët gati asnjëherë dhe ato pak që i kemi nda. Mirëpo është mundësit për të financuar projektin, projektet që ndikojnë në arritje të objektivave të KQZ-ës, ka mundësi në forma të ndryshme.

Unë, i kam potencuar dhe i kam cekur disa nga format që mundemi me i shfrytëzuar, e para është më rrit performancën e shpenzimeve të atyre kuadrave buxhetore që janë për projekte kapitale sepse kemi gjithmonë nën shpenzim, disa zëra buxhetor që janë të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, të cilat gjithmonë kanë trendë të ulta të shpenzimeve, ato mundën të hiqen nga kodet dhe zërat buxhetor sepse nuk kemi nevojë për to dhe duhet të barten në financim të projekteve kapitale. Për projektet e menaxhimit strategjik për KQZ-ës dhe ato që kanë kosto të lart financiare të shfrytëzohen mundësia e financimit të projekteve të mdhaja në faza ose në vite, nëse është një projekt që kushton 1.000.000 euro, ne kemi mundësi që atë buxhet ta ndajmë në 3 vjet, që nëse ka ndonjë projekt me të madh që ti i ndihmon objektivat e KQZ-ës.

Po ashtu, është edhe mënyra tjetër e cila është që kemi mundësin të kemi kaq parë dhe gjejmë partnerin tjetër që na financon ose qeveria, do me thanë bashkëfinancim, janë disa forma që mundet me u konsideruar, do te thotë që nuk mundemi me than që nuk mundemi të i përfundojmë këto projekte, sepse mundësit janë vetëm se duhet të përgatisim planin.

**Valdete Daka:** Faleminderit. Nëse nuk kemi diçka tjetër, kush është për aprovimin e këtij raporti?

Në fund, anëtarët e KQZ-së, miratuan draft raportin e auditimit të përgatitjes së buxhetit 2021

**Alim Rama:** Kemi pasur dhe dy raporte të auditimit të cilat janë ofruar gjatë vitit të cilat, kanë ndalur negative. Vetëm desha të di gjendjen e tyre se, a janë dërguar në prokurori ?

**Valdete Daka:** Po, të dyjat...! E kemi edhe çështjen e vlerësimit vjetor të zëdhënësit, më sa e di unë zyrtarja e personelit nuk është sot këtu. Ndoshta, e lemë për mbledhjen e ardhme. Faleminderit, nëse nuk kemi diçka tjetër...

### **Të ndryshme !**

**Sami Kurteshi:** Krijimi i aplikacionit elektronik për regjistrimin e qytetareve tanë që jetojnë jashtë vendit, edhe një herë po e cekim se nga krejt ajo që kam pa dhe çka kam lexuar, është çështja e aplikimit për regjistrim e cila ka vlerë teknike, ka vlerë shkencore, nuk ka arsye juridike që të hedhet poshtë sepse ka qenë planin e punës së KQZ-ës, për këtë vit është investim kapital, po ashtu dhe ai investim kapital bie poshtë, nuk e di sa janë 50-60.000 euro, po ashtu e lehtëson punën e KQZ-ës sepse, kontrollimi është elektronik nuk është fizik, mundemi më marr më mend që për 20-30 ose 40.000 votues, duhet me i shtyp krejt ato letra dhe duhet me ti kemi resurset njerëzore që ti i kontrollojnë ato krejt.

Aplikacioni elektronik, është diçka që na ka ofruar teknika, aty janë disa të dhëna që aplikacioni elektronik i kontrollon automatikisht vetë, një numër personal që i ka 10 shifra është i rregullt, një numër personal që i ka 11 shifra vetë tregon që nuk është në rregull ose 9 shifra. Prandaj, unë po kërkoj një herë nga KQZ-ja që ta ngrit këtë çështje dhe ti i japim rrugë krijimit të aplikacionit elektronik për regjistrimin e mërgimtarëve në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e ardhshme. Faleminderit...!

**Alim Rama:** Ky aplikacion ka qenë në planë të punës, Këshilli për Operacione Zgjedhore e ka trajtuar dy herë, po për arsye të ndryshme, funksionimi i këtij aplikacionit nuk është berë me shumë për shkaqe politike se sa për shkaqe teknike. Unë veç desha të e rikujtoj KQZ-ën, që KQZ-ja e ka një aplikacion që është shumë ngjason në natyrë që përdoret për ndryshimin e vendvotimeve, që është aplikacioni elektronik. Ai aplikacion është një prej mënyrave se si kish mundur kjo të realizohet atë aplikacion me ja dhen një mundësi që të zgjidhet një vendvotim me mërgatë, por është vetëm një zgjidhje teknike, por fatkeqësisht në KQZ-ë dhe në Këshillin për Operacione Zgjedhore nuk ka pasur interesim nga koleget që ky aplikacion të shkojë më tutje dhe të përfundojë brenda viti.

Raportimi i buxhetit vetëm na dëshmoj që 25% të atyre pak mjeteve shkojnë për zhvillim nuk përdoren për investime kapitale. Kështu që unë mendoj që ka kohë edhe këtë vit që ky proces të përfundojë edhe për këto zgjedhje që qytetaret e



Kosovës që jetojnë jashtë shtetit që ta kenë procesin më të lehtë të aplikimit dhe kjo do i kishte ulur kosto të KQZ-ës, ne numrin e personave se trajnimi shkon elektronik, po ashtu vetëm një dëshmi kërkohet, ajo që ti jen qytetar i Kosovës, e cila ka pas mundësi të aplikohet ai proces pak a shumë i njësoj vetëm që ndodh të aplikacioni për ndryshimin e vendvotimit, kështu që KQZ-ja po ja benë të pa drejtë votuesve jashtë Kosovës, se përderisa ne i japim mundësi këtyre ne Kosovë mos me shkuar në komuna por ta e ndërrojnë vendvotimin nga shtëpia dhe ne nuk ja mundësojmë atyre që jetojnë jashtë Kosovës në mënyrë elektronike, por një proces i cili zgjatet.

Vitin e kaluar, kemi pasur 40.000 numrin e fletave të cilat shtypen një kursim do ishte kompenzuar menjëherë brenda një cikli zgjedhor. Faleminderit.

**Sami Hamiti:** Faleminderit kryetare. Është e vërtet që ne e kemi diskutuar si temë po ashtu dhe si projekt më herët e kemi diskutuar gjatë por e kemi pa që nuk kemi bazë ligjore. Zgjedhjet vete do të shpallen sot ose nesër, do më thanë data e zgjedhjeve, unë besoj së dy koleget e mi që po e ngrisin këtë e dinë që ekziston një iniciativë në kuvend për plotësim dhe ndryshim të ligjit. Unë konsideroj që në këtë fazë nuk mundet të behet në këto zgjedhje por ka mundësi që të kemi dhe të shohim pjesën e aplikimit më formular që të jetë sa me e lehtë aplikimi në këtë pjesë, do me thanë mos të komplikohet situata e aplikimit, për ndryshe çështja e e vetë aplikacionit është çështje e cila është në procedurë të kuvendit dhe besoj që përfundon dhe merret më ligjin. Unë e di që është sepse kam punuar dhe me kanë lypur komente për atë pjesë, ligji ka kaluar edhe pastaj e merr bazën ligjore për tu vendosur.

**Arianit Elshani:** Faleminderit shumë kryetare. Është fakte këtë që e përmenden edhe përfaqësuesit e LVV-je, realisht edhe PDK-ja, në këtë raste si përfaqësues i partisë në KQZ-ë kemi trajtuar aplikacionin që e përmendem, dhe si aplikacion e kemi mbështet realisht në parim të gjithë anëtarët kemi qenë në një farë forme që ajo të kalojë. Mirëpo duhet të kemi parasysh që kemi edhe kufizime ligjore, do të thotë që duhet të dimë që kemi një përgjithësi institucionale dhe që ti i respektojmë ligjet. Andaj është mirë që sot në kuvend të diskutohet kjo çështje që realisht është në komisionet e tyre, edhe unë pres si përfaqësues i PDK-ës, që jo vetëm të i mundësohet votimi i diasporës po, edhe ne anën tjetër, te ju garantohen që të kanë vende të rezervuara që do të përfaqësohen në parlament.

Pra, unë besoj që kjo është zgjidhja më e mirë edhe realisht sa i përket kësaj momentin qe trajtohet atje, dhe në momentin që kemi një bazë ligjore sigurisht që edhe aplikacioni do të jetë një mundësi për KQZ-ën. Sot në këto rrethana që jemi në prag të zgjedhjeve, mbështes edhe idena me të cilën do ta lehtësonim edhe pjesëmarrjen e votuesve të diasporës përmes një ndryshimit, qoftë në formularin apo ne procedurë me të cilin do te ju hapnin rrugë edhe votuesve nga diaspora, që sigurisht është për vendin ton edhe kanë ndikim, edhe elektoral po ne anën tjetër edhe ndikimin ekonomi që i bëjnë vendit e tyre. Faleminderit shumë...

**Sami Kurteshi:** Unë, i dëgjova të 2 koleget, edhe kolegun tim. Sa i përket ndryshimeve ligjore ne komision kjo nuk qëndron sepse unë kam punuar në komisionin për ligjistikion ku janë bërë propozimet, ndryshimet po ashtu edhe kërkesat, kjo çështje e zhvillimit të një aplikacionit elektronik nuk është hapur kurrë. Numrin më të madh të propozimeve në të vërtetë i kam dhënë unë personalisht, mirëpo kur kam punuar në komision për ligjistikion, edhe me përfaqësuesit e diasporës ose mërgatës.

Unë, kam punuar në atë drejtim dhe çështja kryesore në atë drejtim ka qenë mundësia e votimit nëpër institucionet që i ka Republika e Kosovës në vende të jashtme që i ka: ambasada dhe konsullata. Pika e 2 nuk ka asnjë pengës ligjore për zhvillimin e një aplikacionit elektronik. Dhe e 3-ta, sa për votim përfaqësuesit e PDK-ës në komision për çështje ligjore nuk e kanë votuar ligjin për ndryshime. Një kërkesë e imja është zhvillimi i aplikacionit elektronik që edhet mbështetje shkencore që nuk ka pengës ligjore por ka mundësi ligjore, prandaj çdo arsyetim, janë arsyetime për të mos mundësuar një aplikacion elektronik që do ja lehtësonte mërgimtarëve regjistrimin elektronik, nuk ka asnjë pengës tjetër...